

QEVERISJA ME DUAR TË PASTËRTA

(Raport mbi deputetët, ministrat dhe kryetarët e komunave të cilët kanë probleme me ligjin).

Autor: Instituti i Kosovës për Drejtësi (IKD)

Me kontribut të: Nuraje Bllaca, Elsa Kollçaku, Florian Smajli dhe Adea Koci

Redaktor: Gzim Shala

Asnjë pjesë e këtij materiali nuk mund të printohet, kopjohet, shumëfishohet në çdo formë elektronike ose të shtypur, ose në çdo formë të shumëfishimit tjetër pa pajtimin e Institutit të Kosovës për Drejtësi.

Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi ekskluzive e Institutit të Kosovës për Drejtësi - IKD dhe ajo nuk pasqyron pikëpamjet e Byrosë për Çështje të Narkotikëve Ndërkombëtarë dhe Zbatimit të Ligjit (INL) - Departamenti i Shtetit Amerikan dhe NED-it.

RRETH IKD

IKD, Instituti i Kosovës për Drejtësi, është organizatë jo-qeveritare dhe jo-fitimprurëse e politikave publike, fabrikë e mendimeve e specializuar në sektorin e drejtësisë.

IKD

Rr. Ilaz Agushi
Prishtinë
E: info@kli-ks.org
www.kli-ks.org

Përkrahur nga:

Dhjetor, 2022
Prishtinë, Republika e Kosovës



**National Endowment
for Democracy**
Supporting freedom around the world

Lista e shkurtesave:

AKK	Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës
IKD	Instituti i Kosovës për Drejtësi
LDK	Lidhja Demokratike e Kosovës
LVV	Lëvizja Vetëvendosje
MINT	Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë
PDK	Partia Demokratike e Kosovës

Përmbajtja

1. Përmbledhje ekzekutive.....	5
2. Qeverisja me duar të pastërta.....	6
3. Kuvendi	6
4. Qeveria.....	9
5. Kryetarët e Komunave.....	10
6. Dorëheqjet për shkak të problemeve me ligjin.....	10

1. Përmbledhje ekzekutive

Udhëheqja e institucioneve të ndryshme nga persona të cilët kanë probleme me ligjin në kuptim të dënimeve të formës së prerë apo edhe aktakuzave aktive e zbeh besimin e publikut në këto institucione dhe besimin e publikut në drejtshmërinë e proceseve gjyqësore ndaj këtyre zyrtarëve. Për këtë arsye, kriminalizimi i politikës në kuptim të mbajtjes së pozitive të rëndësishme shtetërore nga zyrtarë që kanë probleme me ligjin nuk është në linjë me parimet e qeverisjes së mirë. “Jo, nuk do të kemi ministra me aktakuza”, kishte premtuar Kryeministri Kurti. Përkundër kësaj, IKD në këtë raport ka gjetur se as Kuvendi, as Qeveria dhe as niveli lokal nuk janë të mbrojtura nga kjo dukuri. Në të tri këto raste, IKD ka evidentuar bartës të funksioneve të larta publike, të cilat funksione i mbajnë duke pasur probleme me ligjin.

9.16% e përfaqësuesve të popullit në Kuvendin e Republikës së Kosovës janë persona të cilët kanë probleme me ligjin. Kjo pasi nga gjithsej 120 deputetë, 11 prej tyre janë persona të cilët kanë probleme me ligjin, në kuptim të dënimeve të formës së prerë apo aktakuzave aktive. Deputetët e identifikuar nga IKD si persona të cilët kanë probleme me ligjin janë nga LVV, PDK, AAK dhe një deputet pa grup parlamentar. Kështu, IKD nuk ka identifikuar deputetë nga radhët e LDK apo grupeve të tjera parlamentare nga minoritetet të cilët kanë probleme me ligjin. Tre prej deputetëve të cilët kanë probleme me ligjin janë duke ushtruar mandatin e tyre derisa janë duke u akuzuar për veprime korruptive. Dy prej këtyre deputetëve, Mimoza Kusuri-Lila dhe Jetmire Vrenezi, janë nga Grupi Parlamentar i LVV, si grupi më i madh parlamentar. Të dy këto raste kanë përfunduar në shkallë të parë, ku znj. Kusuri-Lila në shkallë të parë është shpallur e pafajshme derisa znj. Vrenezi në shkallë të parë është dënuar me burgim efektiv. Me aktakuzë për veprime korruptive është duke u përballur edhe deputeti Pal Lekaj, nga radhët e Grupit Parlamentar AAK.

Qeveria e Republikës së Kosovës përbëhet nga gjithsej pesë zyrtarë të cilët kanë probleme me ligjin. Katër nga këta zyrtarë, përfshirë edhe kryeministrin, kanë probleme me ligjin për shkak të veprimeve të hedhjes së gazit lotsjellës në Kuvendin e Republikës së Kosovës. Krahas rasteve në kontekst të veprimeve të hedhjes së gazit lotsjellës në Kuvend, në një rast, një Ministre është e akuzuar për korrupsion. Ministrja e MINT, Rozeta Hajdari, po akuzohet nga Prokurori i Shtetit për mos raportim ose raportim të rremë të pasurisë, vepër penale kjo e cila bënë pjesë në kapitullin e veprave penale të korrupsionit.

Po ashtu, IKD ka gjetur se tri komuna të Republikës së Kosovës udhëhiqen nga persona të cilët kanë probleme me ligjin. Këto komuna janë Komuna e Klinës, Podujevës dhe ajo e Kamenicës.

Gjetjet e IKD-së dëshmojnë se nga të gjithë zyrtarët që aktualisht kanë probleme me ligjin, asnjë prej tyre nuk ka dhënë dorëheqje për shkak të problemeve me ligjin. Kështu, në rastin e Kosovës, duket se ende nuk është krijuar kultura qeverisëse për të lëshuar rrugë në këto raste dhe për t'i lënë institucionet e sistemit të drejtësisë të bëjnë punën e tyre. Andaj, edhe na përsëriten vazhdimisht skena kur zyrtarët e lartë njëren pjesë të ditës e kalojnë në gjykatë si të akuzuar e pjesën tjetër të ditës duke draftuar politika për të mirën publike.

2. Qeverisja me duar të pastërta

Në kritikë ndaj ish-Qeverisë Haradinaj, ish-deputetja e LVV-së, tani Ministre e Drejtësisë, Albulena Haxhiu, shkruante se *“Kryeministri Haradinaj sot paska thënë se nuk do të shkarkohen ministrat që kanë aktakuza për korrupsion dhe pikërisht sot në mbledhjen e Qeverisë ai përkrahu ndryshimet në Kodin Penal që kanë për qëllim largimin nga postet publike të zyrtarëve që kanë aktakuza për korrupsion! Korrupsioni nuk luftohet kështu. Jo me Qeveri të korruptuar dhe jo me hipokrizi dhe hedhje hi syve të qytetarëve. Shteti i së drejtës e liberalizimi i vizave bëhet vetëm me njerëz të pa korruptuar e të ndershëm!”*¹. Për këtë çështje kishte folur edhe Kryeministri aktual, Albin Kurti, duke theksuar prerazi: *“Jo, nuk do të kemi ministra me aktakuza”*².

Këto standarde, janë standarde të cilat zbatohen në shtet të cilat udhëhiqen nga parimet e qeverisjes së mirë. Njëra prej elementeve kryesore të qeverisjes së mirë dhe qeverisjes me duar të pastërta është mos qeverisja me persona të cilët kanë probleme me ligjin. Por, për tu plotësuar ky standard, i njëjti duhet të zbatohet dhe jo vetëm të proklamohet.

Me këtë rast, duhet theksuar se IKD e ka parasysh parimin e prezumimit të pafajësisë, se çdo person është i pafajshëm deri në momentin e nxjerrjes së një vendimi të formës së prerë. Por, udhëheqja e institucioneve të ndryshme nga persona të cilët kanë probleme me ligjin në kuptim të dënimeve të formës së prerë apo edhe aktakuzave aktive e zbeh besimin e publikut në këto institucione dhe besimin e publikut në drejtshmërinë e proceseve gjyqësore ndaj këtyre zyrtarëve. Për këtë arsye, kriminalizimi i politikës në kuptim të mbajtjes së pozitive të rëndësishme shtetërore nga zyrtarë që kanë probleme me ligjin nuk është në linjë me parimet e qeverisjes së mirë.

Përkundër kësaj, IKD në këtë raport ka gjetur se as Kuvendi, as Qeveria dhe as niveli lokal nuk janë të mbrojtura nga kjo dukuri. Në të tri këto raste, IKD ka evidentuar bartës të funksioneve të larta publike, të cilat funksione i mbajnë duke pasur probleme me ligjin.

3. Kuvendi

9.16% e përfaqësuesve të popullit në Kuvendin e Republikës së Kosovës janë persona të cilët kanë probleme me ligjin. Kjo pasi nga gjithsej 120 deputetë, 11 prej tyre janë persona të cilët kanë probleme me ligjin, në kuptim të dënimeve të formës së prerë apo aktakuzave aktive.

Një deputete e Kuvendit të Republikës së Kosovës ka aktgjykime dënuese të formës së prerë, derisa problemet e 10 të tjerëve me ligjin konsistojnë në ekzistimin e aktakuzave aktive.

¹Postimi i Albulena Haxhiu në rrjetin social në Facebook. 13.04.2018. (Shih linkun: <https://www.facebook.com/hapeporten/posts/pfbid02dtNWyN8jiM9g6DvAJ4JpuN2VU8NeZ2uSvXMgqoXWiYLZFnRSW9u9cdrkYZjRqPK11>). (Qasur për herë të fundit më 29 nëntor 2022).

²“Qeverisja e mirë” me aktakuza shumë, ministrat e Kurtit në hall me drejtësinë”. Demokracia. 26.10.2022. (Shih linkun: <https://demokracia.com/qeverisja-e-mire-me-aktakuza-shume-ministrat-e-kurtit-ne-hall-me-drejtisine/>). (Qasur për herë të fundit më 29 nëntor 2022).

Deputetët e identifikuar nga IKD si persona të cilët kanë probleme me ligjin janë nga LVV, PDK, AAK dhe një deputet pa grup parlamentar. Kështu, IKD nuk ka identifikuar deputetë nga radhët e LDK apo grupeve të tjera parlamentare nga minoritetet të cilët kanë probleme me ligjin:

Emri	Grupi parlamentar	Problemi me ligjin	Vepra penale
Glauk Konjufca	LVV	Aktakuzë aktive	“Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm” dhe “Pengimi i personit zyrtar gjatë kryerjes së detyrave zyrtare”
Mimoza Kusari-Lila	LVV	Aktakuzë aktive	“Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar”
Artan Abrashi	LVV	Aktakuzë aktive	“Pjesëmarrja në turmë që kryen veprë penale dhe huliganizëm”
Valon Ramadani	LVV	Aktakuzë aktive	“Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm dhe pengim i personit zyrtar”
Jetmire Vrenezi	LVV	Aktakuzë aktive	“Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar” ³
Salih Zyba	LVV	Aktakuzë aktive	“Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm” dhe “Pengimi i personit zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare”

³ Shënim: Jetmire Vrenezi është dënuar me 3 vite burg dhe 2 mijë euro gjobë më 17 maj 2022 dhe se rasti është në shqyrtim e sipër në Gjykatën e Apelit. (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/rasti-abi-carshia-deputetja-e-vrenezi-dhe-ish-zyrtari-i-komunes-se-prizrenit-denoheh-me-6-vite-burgim/>). (Qasur për herë të fundit më 29 nëntor 2022).

Fitore Dalipi	Pacolli-	LVV	Aktakuzë aktive	“Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm” dhe “Pengimi i personit zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare”
Xhavit Haliti		PDK	Aktakuzë aktive	“Sulmi”
Pal Lekaj		AAK	2 Aktakuza aktive	1) “Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar” 2) “Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të pa autorizuar të armëve”
Time Kadrija		AAK	Aktakuzë aktive	“Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të pa autorizuar të armëve”
Samra Ilijaz		Multietnik	Dënim i formës së prerë	“Mos raportimi ose raportimi i rremë i pasurisë, i të ardhurave, i dhuratave, i dobisë tjetër materiale ose i detyrimeve financiare”

Tabela 1: Deputetët të cilët kanë probleme me ligjin.

Problemet me ligjin të shumicës prej deputetëve të Kuvendit, që kanë probleme të kësaj natyre, ndërlihen me veprat penale të përdorimit të armës, të cilat janë kryer në kontekst të hedhjes së gazit lotsjellës në Kuvend. Përtej kësaj, janë katër deputetë të këtij Kuvendit të cilët kanë probleme me ligjin, në kuptim të veprave penale korruptive.

Semra Ilijaz është e dënuar për mos raportim të pasurisë brenda afatit ligjor, vepër penale kjo e cila bënë pjesë në kapitullin e korrupsionit⁴. Ndërsa, tre deputetë të tjerë, gjersa janë duke ushtruar mandatin e tyre, janë duke u akuzuar për veprime korruptive. Dy prej këtyre deputetëve, Mimoza Kusuri-Lila⁵ dhe Jetmire Vrenezi⁶, janë nga Grupi Parlamentar i LVV, si

⁴ Kodi Nr. 06/L-074 Penal i Republikës së Kosovës. Neni 430.

⁵ “Lirohen nga akuza katër ish-ministrat e Qeverisë Thaçi 2 dhe dy të tjerët për rastin e njohur si “Afera e Hidrocentraleve””. Betimi për Drejtësi. 08 nëntor 2022. (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/shpallen-te-pafajshem-te-akuzuarit-ne-rastin-e-hidrocentraleve/>). (Qasur për herë të fundit më 29 nëntor 2022).

⁶ “Rasti “Abi Çarshia”, deputetja Vrenezi dhe ish-zyrtari i Komunës së Prizrenit dënohen me 6 vite burgim”. Betimi për Drejtësi. 17 maj 2022. (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/rasti-abi-carshia-deputetja-e->

grupi më i madh parlamentar. Të dy këto raste kanë përfunduar në shkallë të parë, ku znj. Kusari-Lila në shkallë të parë është shpallur e pafajshme derisa znj. Vrenezi në shkallë të parë është dënuar me burgim efektiv. Tutje, edhe Pal Lekaj nga grupi parlamentar i AAK gjersa është duke e ushtruar mandatin e tij prej deputeti është duke u përballur për veprime korruptive. Rasti i të njëjtit është në procedurë gjyqësore në shkallë të parë⁷. Në anën tjetër pjesë e kësaj legjislature kishte qenë edhe deputeti nga Lista Serbe, Ivan Todosjeviq, mirëpo i njëjti me 5 dhjetor 2019 ishte dënuar nga Gjykata Themelore në Prishtinë me 2 vite burgim, vendim ky që ishte vërtetuar nga Apeli në vitin 2021. Ky aktgjykim i kishte kushtuar të njëjtit me humbje të mandatit të deputetit. Në po të njëjtin vit Gjykata Supreme e kishte kthyer këtë rast në rigjykim dhe pas rigjykimit, me 19 tetor 2022, shkalla e parë sërish e kishte shpallur Todosjeviq fajtor dhe e kishte dënuar me 1 vit burgim.⁸

4. Qeveria

Qeveria e Republikës së Kosovës përbëhet nga gjithsej pesë zyrtarë të cilët kanë probleme me ligjin, tre prej të cilëve, përfshirë edhe kryeministrin, kanë probleme me ligjin, për shkak të veprimeve të hedhjes së gazit lotsjellës në Kuvendin e Republikës së Kosovës.

Krahas rasteve në kontekst të veprimeve të hedhjes së gazit lotsjellës në Kuvend, në një rast, një Ministre është e akuzuar për korrupsion. Ministrja e MINT, Rozeta Hajdari, po akuzohet nga Prokurori i Shtetit për mos raportim ose raportim të rremë të pasurisë⁹, vepër penale kjo e cila bënë pjesë në kapitullin e veprave penale të korrupsionit¹⁰. Pas ngritjes së aktakuzës, Ministrja Hajdari nuk është prononcuar nëse për këtë çështje duhet apo do të japë dorëheqje. Qëndrim për këtë nuk është dhënë as nga Qeveria. Kështu, gjatë kësaj kohe, Ministrja Hajdari do të ushtrojë detyrën e saj publike duke qenë e akuzuar për korrupsion. Në kundërshtim me premtimet qeverisëse, sot znj. Hajdari mban pozitën e Ministres, përkundër që e njëjta është e akuzuar për korrupsion. Në anën tjetër, në grupin e personave që kanë probleme me ligjin, por se jo për korrupsion, bënë pjesë edhe kreu i Qeverisë, Kryeministri Albin Kurti, i cili është i dënuar për përdorim të armës apo mjetit të rrezikshëm dhe pengim i personit zyrtar gjatë kryerjes së detyrave zyrtare¹¹. Edhe Ministrja që udhëheq me Drejtësinë ka probleme me ligjin.

[vrenezi-dhe-ish-zyrtari-i-komunes-se-prizrenit-denohen-me-6-vite-burgim/](#)). (Qasur për herë të fundit më 29 nëntor 2022).

⁷ “Për shkak të vendimit të KGJK-së, anulohet seanca ndaj ish-ministrit Lekaj dhe tre të tjerëve për rastin e 53 milionë eurove”. Betimi për Drejtësi. 24 nëntor 2022. (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/per-shkak-te-vendimit-te-kgjk-se-anulohet-seanca-ndaj-ish-ministrit-lekaj-dhe-tre-te-tjereve-per-rastin-e-53-milione-eurove/>). (Qasur për herë të fundit më 29 nëntor 2022).

⁸ “1 vit burgim për ish-ministrin Ivan Todosjeviq i akuzuar për nxitje të urrejtjes”. Betimi për Drejtësi. 19 tetor 2022. (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/https-betimiperdrejtesi-com-wp-admin-post-phppost142340actionedit/?fbclid=IwAR2ehC1qnm5TP0OW3va1WWtnngvdDw6ZChlcNke-EQYj2q4BGEV9Ie-qEPO>). (Qasur për herë të fundit më 30 nëntor 2022).

⁹ “Ngritet aktakuzë ndaj ministres Rozeta Hajdari për mosdeklarim të pasurisë”. Betimi për Drejtësi. 14 tetor 2022. (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/ngritet-aktakuze-ndaj-ministres-rozeta-hajdari-per-mosdeklarim-te-pasurise/>). (Qasur për herë të fundit më 29 nëntor 2022).

¹⁰ Kodi Nr.06/L-074 Penal i Republikës, neni 430.2.

¹¹ “Apeli vërteton dënimet ndaj Albin Kurtit dhe deputetëve të tjerë për rastin e gazit lotsjellës”. Betimi për Drejtësi. 18 shtator 2022. (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/apeli-verteton-denimet-ndaj-albin-kurtit-dhe-deputeteve-te-tjere-per-rastin-e-gazit-lotsjelles/>). (Qasur për herë të fundit më 29 nëntor 2022).

Për vepra penale në kontekst të hedhjes së gazit lotsjellës në Kuvend, znj. Haxhiu ka një dënim penal¹² të formës së prerë dhe një aktakuzë aktive¹³. Për vepra penale në këtë kontekst, aktakuzë aktive ka edhe Ministria Arbërie Nagavci¹⁴, derisa Ministri Xhelal Sveçla akuzohet për “pjesëmarrja në turmë që kryen vepra penale dhe huliganizmi”¹⁵.

5. Kryetarët e Komunave

Tri komuna të Republikës së Kosovës udhëhiqen nga persona të cilët kanë probleme me ligjin. Këto komuna janë Komuna e Klinës, Podujevës dhe ajo e Kamenicës.

Komuna e Podujevës udhëhiqet nga Shpejtim Bulliqi, i dënuar me 500 euro për lëndim të lehtë trupor¹⁶. Komuna e Klinës udhëhiqet nga Zenun Elezaj¹⁷, i cili ka aktakuzë aktive për korrupsion e cila është duke u shqyrtuar nga Gjykata e Apelit, derisa në shkallë të parë, Elezaj është dënuar me 4 mijë euro gjobë. Me aktakuzë aktive qeverisë edhe Kryetari i Komunës së Kamenicës, Kadri Rahimaj, e cili është i akuzuar për pengim të personit zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare¹⁸.

6. Dorëheqjet për shkak të problemeve me ligjin

Në demokracitë e konsoliduara, sfera publike shërben si mjet kryesor i shoqërisë për të dalluar krimin prej politikës. Në secilën shoqëri demokratike, zyrtarët e lartë të shtetit, politikanët dhe të gjithë ata që mbajnë përgjegjësi publike, u nënshtrohen normave etike që i përcakton shoqëria. Kësisoj, secili zyrtari që hetohet për krime, publiku i kërkon automatikisht dorëheqjen nga përgjegjësitë publike. Kodi etik, gjithnjë nën vëzhgimin e publikut, funksionon aq mirë sa që rrallë ndodhë që dorëheqja të kërkohej, zyrtarët që janë nën hetime zakonisht dorëhiqen menjëherë, me t'u bërë publike dyshimet për lidhjet e tyre me krimin. Ani pse kodi etik në këtë

¹² Po aty.

¹³ “Apeli kthen në rigjykim rastin ndaj ministres Haxhiu e të tjerëve, lidhur me rastin e gazit lotsjellës në Kuvend”. Betimi për Drejtësi. 19 tetor 2022. (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/apeli-kthen-ne-rigjykim-rastin-ndaj-ministres-haxhiu-e-te-tjereve-lidhur-me-rastin-e-gazit-lotsjelles-ne-kuvend/>). (Qasur për herë të fundit më 29 nëntor 2022).

¹⁴ “Themelorja konfirmon aktakuzën ndaj ministres Nagavci për posedim të sprejit në Kuvend”. Betimi për Drejtësi. 22 nëntor 2022. (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/themelorja-konfirmon-aktakuzen-ndaj-ministres-nagavci-per-posedim-te-sprejit-ne-kuvend/>). (Qasur për herë të fundit më 29 nëntor 2022).

¹⁵ “Sveçla mungon shkak i zhvillimeve në veri në gjykimin ndaj tij dhe 12 të tjerëve, të akuzuar për veprime të dhunshme në protestën e 2013-ës”. Betimi për Drejtësi. 01.08.2022. (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/https-betimiperdrejtesi-com-wp-admin-post-phppost134737actionedit/>). (Qasur për herë të fundit më 29 nëntor 2022).

¹⁶ “Shpejtim Bulliqi dënohet me 500 euro gjobë për incidentin në QKMF”. Betimi për Drejtësi. 13 prill 2022. (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/shpejtim-bulliqi-denohet-me-500-euro-gjobe-per-incidentin-ne-qkmf/>). (Qasur për herë të fundit më 30 nëntor 2022).

¹⁷ “Kryetari i Klinës dënohet me 4 mijë euro gjobë për korrupsion”. Betimi për Drejtësi. 01 dhjetor 2022. (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/kryetari-i-klines-denohet-me-4-mije-euro-gjobe-per-korrupsion/>). (Qasur për herë të fundit më 30 nëntor 2022).

¹⁸ “Mungon prokurorja, dështon seanca në rastin ku kryetari i Kamenicës dhe tre tjerë akuzohen për pengim të zyrtarëve policorë”. Betimi për Drejtësi. 24 nëntor 2022. (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/mungon-prokurorja-deshton-seanca-ne-rastin-ku-kryetari-i-kamenices-dhe-tre-tjere-akuzohen-per-pengim-te-zyrtareve-policore/>). (Qasur për herë të fundit më 30 nëntor 2022).

rast nuk e garanton një shkoqitje absolute të politikës prej krimit, të paktën e krijon përshtypjen e funksionimit të sistemit politik e shoqëror¹⁹.

Në rastin e Kosovës, duket se nuk qëndron kështu. Kjo pasi gjetjet e IKD-së dëshmojnë se nga të gjithë zyrtarët që aktualisht kanë probleme me ligjin, asnjë prej tyre nuk ka dhënë dorëheqje për shkak të problemeve me ligjin. Kështu, në rastin e Kosovës, duket se ende nuk është krijuar kultura qeverisëse për të lëshuar rrugë në këto raste dhe për t'i lënë institucionet e sistemit të drejtësisë të bëjnë punën e tyre. Andaj, edhe na përsëriten vazhdimisht skena kur zyrtarët e lartë njërën pjesë të ditës e kalojnë në gjykatë si të akuzuar e pjesën tjetër të ditës duke draftuar politika për të mirën publike.

¹⁹ “Dekriminalizimi i politikës në Kosovë”. IKD. 21 tetor 2018. (Shih linkun: <https://kli-ks.org/dekriminalizimi-i-politikes-ne-kosove/>). (Qasur për herë të fundit më 30 nëntor 2022).